

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 9, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 3 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 8 nga Rregullorja për punën e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.014351/1 datë 29.8.2014 dhe nr.01-2949/1 datë 30.5.2019, në pajtim me pikën I nën pikën 3 nga Aktvendimi për kryerje të rregullt të inspektimit mbikëqyrës të Drejtorisë për mbrojtje të të dhënave personale, PA1 nr.08-78 datë 15.7.2019 (Nr.yne ark.03-2327/4 datë 23.7.2019) dhe Konkluzën e Këshillit të Agjencisë nr.02-3716/5 datë 30.7.2019, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 29-të mbajtur më 30.7.2019 miratoi:

RREGULLORE

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR KUSHTET, MËNYRËN DHE PROCEDURËN PËR DHËNIEN KOPJE NGA INCIZIM TË INFORMACIONIT TË PUBLIKUAR NË KUADËR TË SHËRBIMIT PROGRAMOR TË RADIODIFUZERËVE NË NIVEL SHTETËTOR, RAJONAL DHE LOKAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË nr.01-5988/1 datë 4.12.2014, me ndërrim nr.01-407711 datë 12.9.2018

Neni 1

Në Rregulloren për kushtet, mënyrën dhe procedurën për dhënien kopje nga incizim të informacionit të publikuar në kuadër të shërbimit programor të radiodifuzerëve në nivel shtetëror, rajonal dhe lokal në Republikën e Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”nr. 180/14 dhe 172/18), (në tekstin e mëtejme: Rregullore për kushtet, mënyrën dhe procedurën për dhënien kopje nga incizim), me Shtojcën nr.1 — Formular me kërkesë për dhënien kopje nga incizim të informacionit të publikuar në kuadër të shërbimit programor të radiodifuzerit, në tabelë „Person fizik“, fusha për shkrimin e „NVAQ” fshihet.

Formulari i ndryshuar me Kërkesë për dhënien kopje nga incizim të informacionit të publikuar në kuadër të shërbimit programor të radiodifuzerit është pjesë përbërëse në këtë Rregullore si (Shtojca nr. 1).

Neni 2

Nëpër të gjithë tekstin e Rregullores për kushtet, mënyrën dhe procedurën për dhënien kopje nga incizim dhe në Shtojcën nr. 1- Formularin me Kërkesë për dhënien kopje nga incizim të informacionit të publikuar në kuadër të shërbimit programor të radiodifuzerit, fjalët: „Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: „Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 3

Në pjesën e mbetur për kushtet, mënyrën dhe procedurën për dhënien kopje nga incizim, nuk ka ndryshim.

Neni 4

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e ardhshme pas ditës së publikimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”

Nr.01-3747/1
31.07.2019
shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetar i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

AGJENCIA PËR SHËRBIME
MEDIATIKE AUDIO DHE
AUDIOVIZUELE

Pallati Panko Brashnarov,
rruga „Makedonija” nr.38, 1000 Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut
Tel: +389 23 103 400
Faks: +389 23 103 401 e-
mail: contact@avmu.mk

Shtojcë nr. 1

(vula pranuese e ASHMA-së)

KËRKESË PËR DHËNIEN KOPJE NGA
INCIZIM TË INFORMACIONIT TË
PUBLIKUAR NË KUADËR TË
SHËRBIMIT PROGRAMOR TË
RADIODIFUZERIT

Person fizik 2

Emri dhe mbiemri	
Adresa	
Telefon	
Posta elektronike e-mail	

Person juridik

Emërtim i plotë	
Selia	
Telefon	
Faks	
Posta elektronike	

Kërkesë për të nxjerrë kopje nga:

- Incizim të informacionit të publikuar në kuadër të shërbimit programor për radiodifuzerin në vijim:

Në pajtim me nenet 9 dhe 10 nga Rregullorja për kushtet, mënyrën dhe procedurën për dhënie kopje nga incizim të informacionit të publikuar në kuadër të shërbimit programor të radiodifuzerëve në nivel shtetëror, rajonal dhe lokal në Republikën e Maqedonisë, nr.01-5988/1 datë 04.12.2014 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.1 80/14),

Plotësohet vetëm nëse kërkuesi është person fizik,

Plotësohet vetëm nëse kërkuesi është person juridik

- Titulli i emisionit në të cilën është publikuar informacioni i kërkuar:

-
- Data dhe koha e publikimit të informacionit:
-

-
- Kopje të incizimit/eve që janë të nevojshme për:

Kërkues: _____

nënshkrim:

Data e paraqitjes së kërkesës:
